

CA mpc shkurt 2025 ALB

1. Lutja e efektshme – “ Prandaj, rrëfejini mëkatet tuaja njëri-tjetrit dhe lutuni për njëri-tjetrin që të shëroheni” (Jakobi 5:16). Kur Fryma e Perëndisë na bind, le të jemi gati të rrëfejme me përlësi gabimet tona. Kjo do të sjellë shërim në marrëdhëniet tona. Jini gjithmonë të gatshëm të bindeni. Perëndia dëshiron të ndikojë në familjen tuaj nëpërmjet lutjeve tuaja.

2. Frenimi i gjykimit – “Po sikur të gjenden vetëm dhjetë atje? Ai u përgjigj: "Për hir të dhjetëve nuk do ta shkatërroj". (Zanafilla 18:32”) Perëndia premtoi se do të frenonte gjykimin e tij nëse do të gjente 10 njerëz të drejtë në Sodomë dhe Gomorë. O Burrë, nëse ti dhe unë jemi të mbështjellë në drejtësinë e Krishtit, ne mund të bëjmë ndryshimin!

3. Lutja e krizës – “Nëse populli im, i cili thirret me emrin tim, do të përulet dhe do të lutet, do të kërkojë fytyrën time dhe do të largohet nga rrugët e tij të liga, atëherë unë do t'i dëgjoj nga qielli, do t'ua fal mëkatën dhe do ta shëroj vendin e tyre” (2 Kronikave 7:14). Perëndia ende apelon që populli i Tij të bëjë një ndryshim. Lutuni për shërimin e tokës tonë.

4. Largimi nga mëkati – “Nuk kënaqem me vdekjen e të pabesit, por që i pabesi të ndryshojë rrugën e tij dhe të jetojë; kthehuni..” (Ezekieli 33:11). Kryqi tregon shenjtërinë e tmerrshme të Perëndisë, por edhe hirin e Tij të mahnitshëm. Lavdëroni Perëndinë që dashuria e Tij është e mjaftueshme dhe se falja është e disponueshme për këdo që largohet nga mëkati.

5. Shpejt – “Më në fund, o vëllezër, lutuni për ne, që fjala e Zotit të përhapet me të shpejtë dhe të lëvdohet, porsë ndër ju” (2 Thesalonikasve 3:1). Problemi kryesor i botës sonë është mëkati, largimi nga Zoti. Zgjidhja për njerëzimin nuk është as politike, as ekonomike, por shpirtërore. Ungjilli është përgjigja e Zotit. Bëhuni një lajmëtar i Lajmit të Mirë sot.

6. Me qëllim – “Do të më kërkoni dhe do të më gjeni kur të më kërkoni me gjithë zemër” (Jeremia 29:13). Jeta është plot me shpërqendrime dhe të shumta janë ofertat për të gjetur përmbushjen në jetë. Por nëse kriza juaj është e një natyre shpirtërore dhe doni një përgjigje të vërtetë, mësoni t'i luteni qëllimisht Atij që është përgjigjja dhe pret që të vini.

7. Përzemërsisht – “Dhe çdo gjë që të bëni, ta bëni me dëshirë të mirë, si për Zotin dhe jo për njerëzit” (Kolozianët 3:23). Njerëzimi jeton, lëviz dhe ekziston nëpërmjet fuqisë mbështetëse të Perëndisë. Ne u krijuam sipas shëmbëlltyrës së Tij dhe për t'i shërbyer Atij me zemër. Bëhuni një njeri që lejon Zotin t'ju frymëzojë, të udhëheqë dhe t'ju përdorë në çdo gjë që bëni.

8. I vakët – Nëse përvetësoni atë që është e përshtatshme, nuk keni bindje të thellë për veten tuaj, për më tepër shkoni me rrjedhën dhe kërkoni të jeni politikisht korrekt, atëherë ju lutemi merrni parasysh. Krishti nuk e pranon këtë lloj qëndrimi. Ai paralajmëron te Zbulesa 3:16 “Por, mbasi je kështu i vakët, dhe as i ftohtë e as i ngrohtë, unë do të të vjell nga goja ime.”

9. Mos harro – “Ki kujdes të mos harrosh Zotin që të nxori nga vendi i Egjiptit, nga shtëpia e skllavërisë”. (Ligji i Përtërirë 6:12). Rehatia dhe sukcesi çojnë lehtësisht në vetëkënaqësi, një kënaqësi e rrezikshme me veten. O Burrë, ji mirënjohës për bekimet e Zotit, shiko prioritetet e tua dhe shërbeji Atij me gëzim.

10. Asnjëherë mos u dorëzo – Zoti kujdeset për ty. “Besnik është Perëndia, i cili nuk do të lejojë që të tundoheni përtej asaj që mundeni, por me tundimin do të sigurojë edhe rrugën për të shpëtuar, që ju të mund ta duroni atë” (1 Korintasve 10:13). Edhe nëse ju duket e pashpresë, mos hiqni dorë kurrë, përkundrazi dorëzohuni me besim dhe përjetoni praninë e Tij.

11. Kërkimi i Zotit - Kultivimi i një vetëdije të shtuar për praninë e Zotit nuk është një zakon i rregullt për shumicën e burrave. Ne jemi të pushtuar dhe të hutuar nga shumë gjëra. Lutuni që burrat të dëshirojnë dhe të praktikojnë vetëdijen për miqësinë e Perëndisë. Perëndia i tha Abrahamit: "Ec para meje dhe ji i përsosur (i paqortueshëm)" (Zanafilla 17:1).

12. Ecni me Perëndinë - Zhvillimi i një bisede të vazhdueshme me Perëndinë mund të bëhet një profesion i shenjtë, pavarësisht se çfarë po bëjmë. Bibla thotë: "Enoku eci me Perëndinë" (Zanafilla 5:24). Ecja me Zotin mund të bëhet një lloj dimension i katërt i ekzistencës sonë dhe është i nevojshëm për zhvillimin e karakterit të perëndishëm. Mësoni të ecni vërtet me Perëndinë.

13. Fokusimi te njeriu i brendshëm – Puna e qëllimshme për karakterin personal nuk është diçka që shumë burra e kanë prioritet. Por ky përqendrim te njeriu i brendshëm është thelbësor për rritjen në ngjashmërinë me Krishtin. Ajo mund të arrihet vetëm përmes Jetës së qëndrueshme. Jezusi tha, pa mua, ju nuk mund të bëni asgjë. Mësoni si të qëndroni në Krishtin (Gjoni 15:5)

14. Favori ndaj Zotit - "Reputacioni im është ai që të tjerët mendojnë se jam; karakteri im është ai që Zoti e di se jam" (D.L Moody). Lutuni që njerëzit të kërkojnë më pak miratimin e të tjerëve dhe të vlerësojnë më shumë favorin e Perëndisë. Nëse përqendrohemi te Zoti që rregullon karakterin tim, atëherë nuk do të më duhet të shqetësohem për reputacionin tim, do shkojë para meje. (Kolozianët 3:12)

15. Dishepullimi autentik - “Nëse doni të dini nëse jam i krishterë, mos më pyesni mua dhe mos pyesni kishën time, pyesni gruan time”. E megjithatë, është e mundur të mashtrojmë edhe gratë tona se po ndjekim Krishtin. Lutuni që burrat të pastrohen, të rrëfihen, të ndjekin vërtet Krishtin në momentet private të jetës, jo vetëm kur të tjerët janë duke parë. (Mateu 23:28)

16. Si të lutemi – “Sepse ne nuk dimë të lutemi siç duhet, por Vetë Fryma ndërmjetëson për ne me rënkitje tepër të thella për fjalë (Romakët 8:26). Kur ne kërkojmë me zell të komunikojmë me Perëndinë, Shpirti i Tij do ta drejtojë lutjen tonë. Prandaj, jini gati për të filluar në çdo kohë.

17. Merrni kohë – “Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemër...” (Ligji i Përtërirë 6:5). Mënyra se si e kaloj kohën time do të zbulojë prioritetet e mia. Dashuria ime ndaj Perëndisë zbulohet gjithashtu nëpërmjet kohës që kaloj duke studiuar Fjalën e Tij dhe kohës që marr për t'u lutur. Jini të gatshëm të përmirësoheni në këto fusha.

18. Filadelfia – “Duajeni me zjarr njëri-tjetrin nga zemra” (1 Pjetrit 1:22). Kuptimi i Filadelfias është dashuri vëllazërore. Disa vende në botë na kujtojnë kuptimin e këtij emri. Dashuria vëllazërore është si një çelës për një jetë që inkurajon besimin te Jezusi. Bëhuni vetë një simbol për Filadelfian!

19. Të bësh të mirën – “Dhe mos e lini pas dore të bërit e mirë dhe ndarjen, sepse Perëndia kënaqet me flijime të tilla” (Hebrenjve 13:16). Si të krishterë ne jemi thjesht administrues të së mirës që na është besuar. Nëse jemi të gatshëm t'i investojmë ato në përputhje me rrethanat për të bërë mirë, ne do të bekohemi shumë.

20. Konsiderata – “Por me përulësi, konsiderojeni njëri-tjetrin si më të rëndësishëm se veten tuaj” (Fp 2:3b). Burrat dhe gratë morën role dhe aftësi të ndryshme nga Zoti. Respekti i ndërsjellë është çelësi për një martesë harmonike, pasi është çelësi i suksesit edhe në çdo marrëdhënie tjetër.

21. Veprimet - 1 Korintasve 3:12 na kujton se investimi ynë në Mbretëri do të testohet nëse zgjat apo jo (v. 13). Kjo ka të bëjë me investimin shpirtëror që bëjmë në bindje ndaj Krishtit dhe kur u shërbejmë njerëzve të tjerë duke filluar nga familja jonë. Jini të gatshëm të investoni në një mënyrë që rezultatet të jenë të përhershme. Zot, më ndihmo ta bëj këtë!

22. Dallimet - Dy burra shkuan në kishë së bashku, por për qëllime të ndryshme. Jezusi e ilustron këtë në shëmbëlltyrën te Luka 18:9-14. Njëri kryente ritet fetare, tjetri u përlul dhe pati një takim me Zotin. Le të bëjmë një ndryshim dhe të jemi të ndershëm me Zotin. Fryti i këtij qëndrimi do të jetë i dukshëm në jetën e përditshme.

23. Qëllimet – Në të gjitha fushat e jetës, burrat sfidohen për të arritur dhe tejkalar qëllimet. Disa janë më të thjeshta, të tjera më të ndërlikuara. Në martesë, Bibla vendos një synim të lartë, domethënë atë për të qenë besnik (shih Mateu 19:8.9). Përhershmëria e martesës është relativizuar, por parimi biblik mbetet i pandryshuar. Zot, më ndihmo të jem besnik.

24. Trashëgimia – Marrëdhënia midis baballarëve dhe fëmijëve të tyre është shumë domethënëse. Në Zanafilla 22, Zoti i kërkon Abrahamit të sakrifikojë djalin e tij Isakun, të cilin ai e donte. Abrahami iu bind me guxim dhe besim. Për t'u lënë një trashëgimi të mirë shpirtërore fëmijëve tanë, ata duhet të përfshihen në përvojat tona me Zotin.

25. Siguria - Kohë të vështira mund të lindin në çdo kohë dhe në çdo familje. Jozefi, në Egjipt, i përgatiti njerëzit për kohë telashe, kur kishte ende bollëk (Zanafilla 41). O Burrë, ndihmoje familjen tënde të kujdeset kur të jetë e mundur, që kriza të mos jetë aq e hidhur! Zot, faleminderit për mençurinë për të menaxhuar pasuritë e familjes sime!

26. Thjeshtësia - Ne shpesh luftojmë me krenarinë dhe ndjenjat e epërsisë, si Komandanti Naamani tek 2 Mbretërve 5. Ai fillimisht u përball me një fëmijë, pastaj me profetin dhe më vonë edhe me shërbëtorët e tij. Por vetëm kur u përlul dhe pranoi të vërtetën e thjeshtë të sëmundjes së tij, ai përjetoi fuqinë shëruese të Perëndisë.

27. Drejtimi – Neve njeriu nuk na pëlqen të na jepet drejtim. Cilado qoftë arsyeja, qoftë krenaria apo nevoja për të ditur më mirë, jini të gatshëm ta merrni parasysht. Mos humbni kohë duke u përpjekur të ndiqni rrugën tuaj. Ju duhet të arrini në destinacionin e duhur. Jezusi tha: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta, askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje” (Gjoni 14:6).

28. Mbrojtja – “Zoti do të të mbrojë nga e keqja; Ai do të ruajë shpirtin tënd” (Psalmi 121:7). Vështirësitë do të vijnë dhe shëndeti dhe pasuritë materiale mund të humbasin. Zoti na kujton se vlera jonë e vërtetë është thelbi ynë, shpirti ynë. Cilado qoftë fati juaj aktual, besojini Atij. Lëreni Atë t'ju mbrojë nga dyshimet, hidhërimet dhe nga i ligu.